

**VENDIM**  
**Nr. 108, datë 21.10.2022**

**MBI VLERËSIMIN E NJOFTIMIT TË PROJEKTIT “MARINA DHE JAHTET E DURRESIT”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

|                       |           |
|-----------------------|-----------|
| Znj. Delina Ibrahimaj | kryetare; |
| Znj. Mimoza Dhëmbi    | anëtare;  |
| Znj. Inida Methoxha   | anëtare;  |
| Znj. Brikena Qela     | anëtare;  |
| Z. Ahmet Mançellari   | anëtar,   |

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 21.10.2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 22.8.2022, “Për Ndihmën Shtetërore”, të ndryshuar (“Ligji”), dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’” (“Rregullorja”), mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e dhënësit potencial të ndihmës shtetërore për projektin e investimit strategjik “Marina dhe jahtet e Durrësit”, i cili konsiderohet nga dhënësi si një projekt që nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Rregullores, me shkresën nr. 19439 datë 21.10.2022, ka paraqitur nëpërmjet strukturës administrative për kontrollin e ndihmës shtetërore (“Drejtoria e Ndihmës Shtetërore”), formularin e plotësuar të njoftimit, dokumentacionin shoqërues të kërkuar në bazë të këtij formulari, si edhe një paketë shtesë aktesh, që përmban marrëveshjet dhe dokumentacionin e trajtuar nga Komiteti i Negocimit të Marrëveshjes, i ngritur me urdhrin nr. 138, datë 3.12.2021, të kryetarit të Komitetit të Investimeve Strategjike, nëpërmjet të cilave paraqiten të dhënat, si vijon:

- Marrëveshje “Mbi bashkëpunimin ekonomik ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”, ratifikuar me ligjin nr. 145/2020;

- Projekti “Marina dhe jahtet e Durrësit”, si ilustrimi më i mirë se si interesi i shtetit shqiptar shprehur nëpërmjet ‘Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit ‘Shqipëria 2030’” shërbehet nga ky Projekt;

- Vendimi i KIS-së nr. 14/6, datë 2.12.2021, dhe vendimi i KIS-së nr. 14/45, datë 18.7.2022, të cilat kanë parashikuar referencat ligjore dhe nënligjore mbi procedurën e aplikimit dhe vlerësimit të projektit të investimit, i cili kërkon pjesëmarrje të shtetit në investim, nëpërmjet vënies në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore, në zbatim të legjislacionit për investimet strategjike;

- Përshkrimi i projektit (përfshirë vlerën, sipërfaqet etj.);
- Kërkesa e investitorit për bashkëpjesëmarrjen e shtetit në projekt;
- Përshkrimi i përfitimeve të projektit (të ardhurat direkte/indirekte);
- Përshkrimi i risqeve të projektit;

- Marrëveshjet e dakordësuara mes KNM-së dhe përfaqësuesve të subjektit “Eagle Hills Real Estate Development” sh.p.k.;

- Dokumentacioni në lidhje me krijimin e SPE-së, “Albania Seaport Development Company”, dhe dokumentacioni i subjektit investues “Eagle Hills Real Estate Development” sh.p.k.;

Komisioni i Ndihmës Shtetërore nëpërmjet Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 18 dhe 21 të ligjit, mbështetur në njoftimin (përfshirë të dhënat dhe analizën) e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, vlerëson nëse masat dhe marrëveshjet e propozuara përbëjnë ose jo ndihmë shtetërore dhe janë subjekt i Ligjit;

Duke iu referuar kërkesës, rezulton se shteti, në këtë marrëdhënie juridike parashikon të bëhet pjesëmarrës si bashkaksionar në një ndërmarrje ekonomike që do të operojë në tregun e lirë dhe do të gjenerojë të ardhura për shtetin. Bazuar në biznesplanin dhe dokumentet e tjera të paraqitura, rezulton se norma e kthimit të investimit parashikohet të jetë një normë kthimi e

pranueshme për një investitor privat në një ekonomi tregu, e mbështetur në analizën e IRR-së (norma e brendshme e kthimit), kohëzgjatjen e investimit dhe duke e krahasuar atë me gjendjen e tanishme të aseteve dhe koston oportune në treg. Në këtë mënyrë, bazuar në nenin 3 të ligjit, rezulton se shteti (nëpërmjet burimeve shtetërore) vepron në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu dhe, si rrjedhojë, masat mbështetëse për entitetin ku vetë shteti do të jetë ortak dhe marrëveshjet e propozuara nuk hyjnë në fushën e zbatimit të Ligjit,

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Masa e njoftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk përbën ndihmë shtetërore.
2. Ky vendim i njoftohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
3. Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Delina Ibrahimaj**